



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

SHTOJCË
MBI
SQARIMIN PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS PA E NDARË NË LOTE

Nga NJP, e ngritur me urdhrin e Titullarit të AK nr. 311, datë 22.05.2023, administruar me nr. 127/79 prot., për procedurën e prokurimit me objekt ‘Blerje materiale mjekësore për Shërbimin e Kardiokirurgjisë në QSUNT, për 24 muaj, **Loti 1 – Proteza, Kanjula dhe materiale të përgjithshme**’, me fond limit: **118 934 566,67** (njëqind e tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**, dhe **128 451 946,67** (njëqind e njëzet e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë me TVSH**, me nr. **REF-70163-05-23-2023**, u konstatua se në dokumentet standarde të tenderit nuk është dhënë sqarimi për zhvillimin e procedurës, pa e ndarë atë më parë në lote. Njësia e prokurimit thekson rëndësinë e mirëzbatimit të parashikimeve ligjore të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe sjell në vëmendje se, në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 39(1) parashikon në mënyrë eksplicite, si më poshtë vijon:

“Neni 39

Ndarja e kontratave në lote

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. (...)”

Duke marrë në konsideratë këtë parashikim ligjor, dokumentacionin e administruar nga NJP për këtë procedure prokurimi, si dhe faktin se kjo procedurë është e rishpallur, sqarojmë të gjithë OE se:

- Ky lot është zhvilluar më herët nga AK me nr. **REF-57954-02-03-2023** të procedurës bazë dhe nr. **REF-57958-02-03-2023** të lotit 1 - Proteza, kanjula dhe materiale te pergjithshme dhe është anuluar në bazë të nenit 98(1), gërma “b” të LPP; dhe
- Objekti i prokurimit është i përcaktuar në zëra për shërbimin e kardiokirurgjisë, pra çdo OE/BOE, duhet të ofertojë me çmim për njësi për çdo zë, të cilat pasqyrohen në specifikimet teknike të Dokumenteve të Tenderit

NJËSIA E PROKURIMIT: